

## **KLOTILDA BUSHKA**



**Datëlindja:** 11.04.1979

**Vendlindja:** Tiranë

**Email:** Klotilda.Bushka@parlament.al

### **Jetëshkrimi:**

Në vitin 2001, znj. Bushka është diplomuar për drejtësi, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë. Ajo ka eksperiencë pune si koordinatore programi (1998-2000). Ajo është anëtarësuar pranë Dhomës së Avokatëve Tiranë që në vitin 2003. Në vitet 2000-2008 ka punuar si avokate pranë një studio ndërkombëtare ligjore dhe në vitet 2015-2017 ka qenë avokate. Prej vitit 2008 deri në 2015 ka mbajtur detyrën e këshilltares ligjore në Gjykatën e Lartë. Nga viti 2018-2020 ka qenë pedagoge e jashtme në Departamentin e të Drejtës Civile, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Që nga muaji shtator 2017 e në vijim, znj. Bushka ka qenë deputete e Kuvendit të Shqipërisë. Gjatë kësaj periudhe ajo ka qenë anëtare e disa komisioneve parlamentare si Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe anëtare e Këshillit të Legjislacionit dhe Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Ajo ka qenë anëtare e disa komiteteve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Znj. Bushka ka marrë pjesë në disa programe kualifikimi, ndër të cilat: Programi i avancuar trajnimi mbi administrimin e drejtësisë dhe efikasitetin në menaxhimin e gjykatave, Asser Institute, Hollandë (2013 – 2014); Programi i trajnimit vazhdues, Shkolla e Magjistraturës (2008 – 2013); Praktika gjyqësore e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe zbatimi i saj nga autoritetet gjyqësore shqiptare, USAID, 2012; Trajnime të avancuara mbi zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, të drejtën familjare, mosmarrëveshjet administrative, të drejtat e njeriut, etj, organizuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, ABA/CEELI, Këshilli i Evropës, (2002 – 2008), etj.

Ajo ka qenë anëtare e Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore, organ këshillimor pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë; anëtare e grupit të punës së shoqërisë civile për krijimin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile si një mekanizëm bashkëpunimi midis këtij sektori dhe qeverisë shqiptare në procesin e zhvillimeve demokratike të vendit, mirëqeverisjen dhe rritjen e transparencës në vendimmarrjen publike (2013/2014); anëtare e Bordit Drejtues të Freja Academy, një organizatë ndërkombëtare, e krijuar nga një rrjet i gjerë i organizatave të shoqërisë civile nga Ballkani dhe vendet e Bashkimit Evropian (BE), me fokus forcimin e demokracisë nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së shoqërisë civile në vendimmarrjen publike dhe në proceset integruese me BE (2011).

Ajo është aktiviste e shoqërisë civile që prej vitit 1997. Ajo ka kontribuar në këtë sektor me ekspertizën e saj ligjore për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht për përparimin e të drejtave të grave dhe vajzave në shoqërinë shqiptare si dhe për përfshirjen e publikut në vendimmarrje.

Znj. Bushka është autore dhe bashkëautore në disa botime si manuale, artikuj etj në fushën e drejtësisë dhe në atë sociale.